



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
URDHRI I PSIKOLOGUT  
KËSHILLI KOMBËTËAR



Tiranë më, 07.11.2023

**V E N D I M**

Nr.31, datë 07.11.2023

Në mbështetje të ligjit 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në nenin 16.2.d), të këtij ligji, Këshilli Kombëtar,

**VENDOSI:**


Të miratojë me unanimitet të të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar prezent ndryshimet e propozuara të zyrës juridike, konkretisht:

Në Kreun 4, pika 4.2. të Rregullores së Edukimit në Vazhdim me emërtimin “Monitorimi dhe vlerësimi përfundimtar” të shtohen plotësimet e mëposhtme:

- 4.2. Eksperti i pavaruar ka detyrimin të monitorojë aktivitetin e edukimit në vazhdim për të siguruar zbatimin e standardeve dhe kritereve të parashikuara. *Pjesëmarrja e ekspertit të pavarur me qëllim monitorimin dhe vlerësimin e aktivitetit, duhet të jetë jo më pak se 70% të orëve efektive të secilës ditë të aktivitetit.*
- Në Kreun 4, pika 4.4. të Rregullores së Edukimit në Vazhdim me emërtimin “Monitorimi dhe vlerësimi përfundimtar” të shtohen plotësimet e mëposhtme:
- 4.4. Pas përfundimit të aktivitetit, ofruesi duhet të kryejë procesin e vlerësimit, duke dorëzuar pranë ekspertit të pavarur listën e pjesëmarrësve në aktivitet dhe rezultatet e procesit të vlerësimit të aktivitetit të kryera nga vetë ofruesi, si dhe nga pjesëmarrësit në aktivitet. *Frekuentimi i pjesëmarrësve duhet të jetë jo më pak se 85% të orëve efektive të secilës ditë të aktivitetit.*

**PRESIDENTE E URDHRI**

**Dr. Valbona TRESKA**



**SEKRETARE**

**Armira BABOÇI**

Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, kati II, Ap.9, Tiranë, email:  
[sekretaria@urdhriipsikologut.al](mailto:sekretaria@urdhriipsikologut.al), Tel.: 0035542209927